



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primitjen / Prodatur Received / Delivered	07-06-2023	3	viti gati year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHHC	4615/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.704/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.704/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankueset dhe

kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet Poshtë si e pajtuar ankesa me numër A.nr.704/2023 e datës 04.05.2023 e parashtruar nga ankueset dhe

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të implementimit të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik me date 18.01.2023 nxjerr Vendimit me numër KGJK.nr.01/2023 për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor .

Ankueset dhe të punësuarat në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në pozitën "Këshilltare Profesionale" në Gjykatën Komerciale, me datën 31.01.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër Vendimit me numër KGJK.nr.01/2023 të datës 18.01.2023 respektivisht kundër klasifikimit të pozitës se tyre në grupin J klasa J 11 me koeficient 7.14.

Ankueset të pakënaqura me mos përgjigjen nga organi i punësimit, me datën 04.05.2023 kanë parashtruar ankese me numër protokollit 4029/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër klasifikimit të pozitës se tyre në

grupin J klasa J 11 me koeficient 7.14, si dhe të njëjtat kërkojnë që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës të detyroj Këshillin Gjyqësor të Kosovës që brenda afatit 30 (tredhjet) dite të vendos lidhur me ankesën e ankueseve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 18.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër të protokollit 4029/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër KGJK.01/2023 të datës 18.01.2023 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën me numër 01/88 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesja grup ankuesish në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me numër KGJK.nr.24/2023 të datës 03.02.2023 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.03.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 18.05.2023; Vendimin me numër të referencës DS-778/2022 të datës 27.07.2022; Akt emërimit të datës 10.01.2018; Vendimin me numër të referencës DS-777/2022 të datës 27.07.2022; Akt emërimit të datës 10.01.2018; Procedimin në sistemin e pagave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës të datës 13.02.2018; Kërkesën me numër 03/458 të datës 24.03.2023 për korrigjimin e klasifikimit të koeficienteve në sistemin gjyqësorë sipas ligjit të ri të pagave; Listën e nëpunësve në Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës lidhur me klasifikimin e nëpunësve sipas koeficienteve; Emalin e datës 01.01.2023 të drejtuar Emalin e datës 18.05.2023 të drejtuar emalin e datës 11.05.2023 të drejtuar Listën e pagave për muajin Maj-2023; Listën e pagave për muajin Mars-2023; Emalin e datës 05.06.2023 të lidhur me dëshminë se ankuesja nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueseve dhe është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimit të datës 10.01.2018 të ankuses rezulton se e njëjta fillimisht është punësuar në pozitën e punës "Këshilltare Profesionale" në Gjykatën Themelore në Prishtinë" ndërsa sipas Vendimit me numër të referencës DS-778/2022 të datës 27.07.2022 e njëjta është ri caktuar-transferuar në pozitën "Këshilltare Profesionale" në Gjykatën Komerciale me koeficient tetë (8) të pagës. Tutje po ashtu sipas Akt emërimit të datës 10.01.2018 të ankuses rezulton se e njëjta fillimisht është punësuar në pozitën e punës "Këshilltare Profesionale" në Gjykatën Themelore në Prishtinë" ndërsa sipas Vendimit me numër të referencës DS-777/2022 të datës 27.07.2022 e njëjta është ri caktuar-transferuar në pozitën "Këshilltare Profesionale" në Gjykatën Komerciale me koeficient tete (8) të pagës sipas sistemit të vjetër.

Ankuesja dhe me datë 04.05.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KGJK.nr.01/2023 të datës 18.01.2023 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjegjësisht kundër klasifikimit të pozitës së tyre në grupin J klasa J 11 me koeficient 7.14.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Aktgjykimin Ref.Nr.AGJ 1363/19 të datës 20.02.2019 të Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Aktgjykimin KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht duke ju referuar pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ku është përcaktuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dhe pikës 207 po të këtij aktgjykimi ku theksohet se: Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj Personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre”, Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në raport me institucionet e pavarura kushtetuese zbatohen aktet e tyre të brendshme dhe Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për aq sa nuk cenohet pavarësia e tyre.*

Meqenëse për Këshillin Gjyqësor të Kosovës është i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku i njëjti ka përcaktuar se secili institucion i administratës, që ka nëpunës civilë do të themeloj organ të veçantë për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil, konkretisht neni 81 paragrafi 2 i këtij ligji, ka përcaktuar se: *“Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës”*. Po ashtu, me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 50 është përcaktuar se *„Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”* dhe që *„Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkelje së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike”*. Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka analizuar dëshmitë e ofruara nga ankueset dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankueset me datë 31.01.2023, kanë parashtruar ankesë tek Kryesuesi i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, respektivisht kundër klasifikimit të pozitës së tyre në grupin J, klasa J 11 me koeficient 7.14, ndërsa nuk kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretarit të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke marrë parasysh këtë fakt ka konstatuar se ankesa e ankueseve _____ dhe _____ është e palejuar, pasi është parashtruar në Këshill pa shtjerrë procedurat e brenasme të ankesave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar që ankueset _____ dhe _____ është dashur të parashtrojnë ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, ashtu siç përcaktohet në neni 4 paragrafin 1 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është



përcaktuar se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës"*, pastaj në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke u bazuar në nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit..."* dhe nenit 3 paragrafi 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtimit të ankesës në Këshill, ankueset duhet t'i kenë shterur procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit..."*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankueses dhe e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura dhe si i tillë është e para afatshme.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 704/2023.

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTA

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve dhe
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Këshillin Gjyqësorë të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së